

## AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR “shpk”

Në Tiranë, sot më datë 22.01.2019, unë e poshtëshënuara:

1- Mirlinda Heidorn, e datëlindjes 01.02.1979, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal H95201205U,

me cilësinë e “Ortakut të vetëm” deklaroj se me vullnet të lirë e të plotë, mbështetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit“, i ndryshuar, krijoj shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, “Constech Group“ *shpk*,

### Neni 1 Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin “Constech Group”, dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

### Neni 2 Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

### Neni 3 Selia

Shoqëria e ka selinë në adresë: Rruga “George W. Bush”, 2 kullat e kuqe, kulla 1, kati 3-të, hyrja nr 40-42, Njësia Bashkiake nr 2, Tiranë, Shqipëri.

### Neni 4 Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- Ndërtime civile ekonomike dhe industriale dhe industriale, rikonstruksione godinash, veshje fasade etj.
- Punime dheu, sistemime terracime terrenesh, vepra kullimi e vaditëse etj.
- Ndërtim rruge, veshje rrugesh me asfaltobeton, ndërtim mbishtrese etj.
- Ndërtim vepra arti te vogla deri në 6 metra, ujësjellësa kanalizime etj.
- Prodhim dhe tregëtim materiale ndërtimi.
- Tregëtim me shumicë dhe pakicë dhe import eksport të:
  - Mallra të ndryshme industriale, ushqimore, hidrosanitare, hidraulike etj.
  - Makineri-pajisje industriale e bujqësore, pjesë këmbimi të ndryshme

etj.

- Transport mallrash brenda dhe jashtë vendit.

Neni 5  
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj pa afat.

Neni 6  
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërisë është 100.000 Lekë. Ky kapital zotërohet nga ortakut i vetëm znj. Mirlinda Heidorn, në masën një (1) ortak një (1) kuotë me vlerë 100.000 Lekë.

Neni 7  
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj ne Qendren Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8  
Organi Vendimmarrës

Ortakut i vetëm është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

#### Neni 9 Administratori

- Ortaku i vetëm emëron një (1) person fizik si Administrator të Shoqërisë, i cili mund të jetë aksioner ose jo dhe që do të jetë përgjegjes për çështjet e përditshme të Shoqërisë sipas kufizimeve të parashikuara nga ligji në fuqi dhe nga statuti.
- Administratori emërohet për një afat tre (3) vjeçar dhe mund të rizgjidhet.
- Shoqëria merr angazhime me nënshkrimin e vetëm të Administratorit, sipas kufizimeve të parashikuara nga ligji në fuqi dhe nga statuti.
- Administratori i Shoqërisë duhet ti raportojë ortakut të vetëm.
- Administratori i Shoqërisë ka të drejtën dhe detyrimin për të përfaqësuar Shoqërinë në përputhje me parashikimet e ligjit në fuqi dhe statutit.
- Shoqëria administrohet nga administratori znj. Mirlinda Heidorn.

#### Neni 10 Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 11 Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 2 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nën per nen nga Ortaku themelues i shoqërisë tregtare "Constech Group" shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën orgjinale.

#### **ORTAKU I VETËM**

**MIRLINDA HEIDORN**

Mirlinda Heidorn

